



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI BASHKIAK

NJOFTIM

Prot.

Përmet, 12/12/2025

Lënda: Njoftim për mbajtjen e mbledhjes të Këshillit të Bashkisë Përmet

I nderuar këshilltar.

Ju njoftoj se ditën e **Mërkurë** datë **17.12.2025** ora **11:00**, në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë zhvillohet mbledhja e radhës, me këtë rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Për buxhetin e Bashkisë për vitin 2026 dhe përcaktimin e numrit të punonjësve të bashkisë, institucioneve dhe njësive administrative në varësi të saj.
3. P/V Për miratimin e fazës përfundimtare (Faza III) të Buxhetit Afatmesëm 2026–2028, Bashkia Përmet.
4. P/V Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2026–2028 dhe Buxhetit Vjetor 2026 të Bashkisë Përmet.
5. P/V Për miratimin e nivelit të pagave dhe shpërblimeve të punonjësve dhe të personave të tjerë të zgjedhur ose të emëruar të Bashkisë Përmet dhe të institucioneve që varen prej saj, për vitin 2026.
6. P/V Për miratimin e planit të punës, të konsultimeve dhe planit të buxhetit të Këshillit të Bashkisë Përmet për vitin 2026.
7. P/V Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programet sociale të strehimit për vitin 2026.
8. P/V Për miratimin e listës së bonusit të qirasë në tregun e lirë për dhënie apartamentesh për familjet e pastreha me status të miratuar.
9. P/V Për miratimin e masës së qirasë mesatare të apartamenteve në tregun e lirë për vitin 2026 në Bashkinë Përmet.
10. P/V Për dhënie bursash dhe pagesash për nxënësit e shkollave të mesme profesionale publike për vitin shkollor 2025–2026.

11. P/V Për përbërjen dhe funksionimin e Komisionit të Strehimit Social në Bashkinë Përmet.
12. P/V Për miratimin e listës së individëve përfitues të shërbimit “Një vakt ushqimor”, pjesë e projektit “Përqaftimi i Shpresës – një OAZ për ata që kanë nevojë”, për vitin 2026.
13. P/V Për miratimin e menuve dhe kuotës ushqimore për ofrimin e vakteve ushqimore në kuadër të projektit “Përqaftimi i Shpresës – një OAZ për ata që kanë nevojë”.
14. P/V Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Përmet dhe FSHF-së, miratimin e financimit nga FSHF-ja për rikonstruksionin e pjesshëm të stadiumit “Durim Qypi”, Përmet, si dhe dhënien e autorizimit Kryetarit të Bashkisë për nënshkrimin e saj.
15. P/V Për financimin e disiplinave sportive: basketboll, pingpong dhe alpinizëm, si dhe të projekteve me objekt rinor, sipas buxhetit 2026 të Bashkisë Përmet dhe zbatimit përmes metodologjisë LODD.
16. P/V Për miratimin e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë, muaji dhjetor 2025.
17. P/V Për miratimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmë ekonomike deri në 6%.
18. Hapësirë diskutimi e kërkuar nga qytetarët me tematikë: “Për zgjidhjen e ngërçit 28-vjeçar të godinës së rrënuar në qendër të qytetit të Përmetit”.

Kryetari i Këshillit të Bashkisë Përmet
Anila DHIMITRI

